



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:180332
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07033556

AA.nr.333/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, e me bashkëpunëtoren profesionale, Hajrije Krasniqi, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, M.Z, nga Komuna e Shtimes, kundër të paditurit, Këshillit Prokurorial i Kosovës, Komisionit për Rishqyrtim me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Saranda Sokoli Berisha, me bazë juridike anulim i njoftimit-vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.1845/21, të datës 24.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;12.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, M.Z, nga Komuna e Shtimes, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1845/21, i datës 24.01.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1845/21, të datës 24.01.2024, është vendosur, “*Refuzohet kërkesëpadia e paditësit M.Z me të cilën ka kukuar që të anulohet vendimi i të paditurit Komisionit për rishqyrtim KPK/nr.517/ i dt.22.07.2021 dhe të detyrohet që të nxjerr vendim se paditësi ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas konkursit për prokuror të shtetit, si e pabazuar*”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka ushtruar ankese, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës gjyqësore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike të çështjes dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovojë ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar.

E paditura, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet

Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me njoftimin-vendimit me nr.517/2021 të datës 22.07.2021, e paditura komisioni për rishqyrtim i KPK-se, e ka njoftuar paditësin se pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacioneve përcjellëse kanë vendosur se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur për prokuror të shtetit me 11 maj 2021.

Paditësi i pa kënaqur me njoftimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ më datë;16.08.2021, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padisë dhe anulimin enjoftimit të paditurës nga arsyet e dhëna në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër njoftimit kontestues të paditurës, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe provave të administruara në seancën, përgjegjës në padinë në shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Gjykata për të vendosur çështjen e paditësit fillimisht iu referua ligjit nr.05/l-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit neni 19, kushtet e përgjithshme i cili përcakton “ 1.6. të ketë së paku tre (3) vite përvojë në fushën juridike”, po dhe Ligjit Nr.08/l-167 për Prokurorin e Shtetit neni 24 paragrafi 2. “për qëllime të këtij neni përvoja në fushën juridike përfshinë përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat. me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me padi kjo gjykatë ‘iu referua edhe dispozitës ligjore të UA Nr.07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të shtetit neni 8 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6 i cili përcakton se “kandidatët për prokurorë të shtetit, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim: dëshminë mbi përvojën e punës siç është përcaktuar me ligjin për KPK-së. Gjykata pasi ka administruar provat si me lartë dhe vlerësuar në drejtim të pretendimeve të paditësit, ka konstatuar se vendimi i të paditurës është i nxjerre me vërtetim të drejt gjendjes faktike dhe ka dhanë arsyetim të mjaftueshëm. Po ashtu bazuar në prova gjykata ka gjetur se nga shkresat e lëndës i paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit ka vlerësuar drejtë shkresat e lëndës në mbështetje me provat e prezantuara vetëm kontratat përvoja e punës si arsimtar lëndorë pa specifikim se në cilat lëndë në shkollë të mesme ka dhe mësim si dhe provojnë përkthyes, e që komisionet, Rekrutues dhe ai Ri-shqyrtues ketë provoj si të tillë me të drejt dhe sipas vlerësimit të gjykatës nuk kanë mundur të pranoj, si “përvojë profesionale juridike”. Paditësi po ashtu as dhe në procedurë gjyqësore ska mundur të dëshmoj me fakte mbi prova se ka plotësuar kriteret e konkursit të shpallur nga KPK i dt.27.04.2021 se kishte ofrua dëshmi për 3 vite provoj pune në fushën juridike. Gjykata ka vlerësuar dhe pretendime e paditësit ka ofrua dëshmuar përvojën e kërkuar për 3 vite provoj në fushën juridike po nga kontrata 05/1125 shihet i njëjti ka punuar arsimtar në Shkollën “Naim Frashri”, arsimtar lëndor pa specifikuar cilat lënd. Prandaj gjykata nuk ka mundur të aprovoj pretendime e paditësi se i njëjti i kishte plotësuar kushtet sipas konkursit për pozitën e shpallur. Gjykata ka vlerësuar dhe perëndimet tjera të paditësi ishte diskriminuar, trajtuar jo barbarët dhe janë shkelur drejta e tij në konkursin e pretenduar por të njëjtat si ka parë me ndikim në një vendosje tjetër pasi kandidatët për prokurorë të shtetit, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim: dëshminë mbi përvojën e punës siç është përcaktuar me ligjin për KPK-së. Andaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative nga ana e të paditurës drejtë është vërtetuar gjendja faktike si dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka vendosur lidhur me ankesën e paditësit. Dhe në këtë çështje nuk*

gjeti bazë se është zbutur ligj në dem të tij. Mbi këto arsye thënie e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, sipas vlerësimit të kolegjit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditësi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave procedurale, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të aktvendimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimin të gabuar të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se paditësi në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në ankesë, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kjo për faktin se bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata e shkallës së parë për ti vlerësuar ligjshmërinë e aktit administrativ drejtë ka nxjerrë përfundim se, *“Gjykata pasi ka administruar provat si me lartë dhe vlerësuar në drejtim të pretendimeve të paditësit, ka konstatuar se vendimi i të paditurës është i nxjerre me vërtetim të drejtë gjendjes faktike dhe ka dhanë arsyetim të mjaftueshëm. Po ashtu bazuar në prova gjykata ka gjetur se nga shkresat e lëndës i paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit ka vlerësuar drejtë shkresat e lëndës në mbështetje me provat e prezantuara vetëm kontratat përvoja e punës si arsimtar lëndorë pa specifikim se në cilat lëndë në shkollë të mesme ka dhe mësim si dhe provojnë përkthyes, e që komisionet, Rekrutues dhe ai Ri-shqyrtues këtë provoj si të tillë me të drejtë dhe sipas vlerësimit të gjykatës nuk kanë mundur të pranoj, si “përvojë profesionale juridike”. Paditësi po ashtu as dhe në procedurë gjyqësore ska mundur të dëshmoj me fakte mbi prova se ka plotësuar kriteret e konkursit të shpallur nga KPK i dt.27.04.2021 se kishte ofrua dëshmi për 3 vite provoj pune në fushën juridike”.*

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu aktgjykimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale konkretisht nenit 19, të Ligjit nr.05/l-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe nenit neni 24 par.2 të Ligjit Nr.08/l-167 për Prokurorin e Shtetit.

Mbi këto arsye kolegji i apelit pretendimet ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.333/2024, datë;12.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti